

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E TE SIGURUARIT DHE PALEVE TE TRETA

I SIGURUARI APO ÇDO PERSON TJETËR I INTERESUAR I CILI PRETENDON SE NGA ANA E INSIG JETË SH.A. NUK JANË PËRMBUSHUR KËRKESAT LIGJORE APO KUSHTET E KONTRATËS SË SIGURIMIT, MUND TË PARAQESË NJË ANKIM NË PËRPUTHJE ME FORMËN DHE PROCEDURËN E PËRCAKTUAR NË KËTË FORMULAR.

FORMA E ANKIMIT:

1. Ankimi paraqitet në format e mëposhtme:
 - a) Me shkrim e depozituar në zyrën e protokollit ose e depozituar në rrugë elektronike në adresën e publikuar;
 - b) Me telefon në numrat e publikuara në faqen zyrtare www.insig-jete.al.
2. Ankimi duhet të përmbajë:
 - a) Emrin dhe kopje të dokumentit të identifikimit të ankuesit;
 - b) Adresën e ankuesit;
 - c) Të dhënat për ngjarjen e sigurimit ose çdo fakt ose rrethanë tjetër për të cilën ankohet.
 - d) Kopje të kontratës (policës) së sigurimit ose çdo dokument tjetër mbi të cilin ankuesi mbështet faktet ose rrethanat e pretenduara;
 - e) Shkaqet e ankimit; si dhe
 - f) Çdo dokument tjetër që vlerësohet i rëndësishëm nga ankuesi.

SHQYRTIMI I ANKIMIT

1. INSIG JETË SH.A. pas marrjes së ankimit verifikon përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në nenet 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje. Në rast se ankimi nuk plotëson këto kërkesa kthen për plotësim ankimin. INSIG JETË SH.A. nuk shqyrton ankesat apo kërkesat anonime.
2. INSIG JETË SH.A. nuk merr në shqyrtim ankimet për çështje të cilat janë njëkohësisht në shqyrtim gjyqësor nga Gjykata apo Prokuroria, si për të cilat është dhënë një vendim i formës se prere nga organet kompetente të drejtësisë.
3. INSIG JETË SH.A. nëse gjatë shqyrtimit të ankimit konstaton se çështja për të cilën është paraqitur ankim është njëkohësisht në shqyrtim nga organet e prokurorisë pezullon shqyrtimin deri në disponimin e vendimeve të organeve kompetente.

PROCEDURAT DHE AFATET E SHQYRTIMIT TË ANKIMIT

1. INSIG JETË SH.A. gjatë shqyrtimit të ankimit mund të kryejë rast pas rasti një ose të gjitha veprimet e mëposhtme:
 - a) Mund të kërkojë informacion shtesë nga ankuesi, i cili duhet të depozitohet në INSIG JETË SH.A., brenda 5 ditëve pune nga në të cilën ankuesi merr dijeni;
 - b) Për qëllime të sqarimit të rrethanave për çështjen e ankuar INSIG JETË SH.A. mund të organizojë takime me ankuesin;
2. INSIG JETË SH.A. pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit, nëse konstaton që nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit dhe/apo kushtet e kontratës së sigurimit kthen për rishqyrtim Departamentit përgjegjës çështjen e ankuar duke vënë në dijeni dhe ankuesin.
3. INSIG JETË SH.A. shqyrton ankimin dhe njofton ankuesin brenda 30 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës apo ankesës.

ANKESAT NDAJ NDËRMJETËSVE NË SIGURIME

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen edhe për procedurat dhe shqyrtimin e ankesave të depozituara në INSIG JETË SH.A. ndaj ndërmjetësve në sigurime me të cilën bashkëpunon INSIG JETË SH.A..

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT

Informacioni dhe dokumentacioni i marrë nga INSIG JETË SH.A. për çështjen në shqyrtim përdoret vetëm qëllimet për të cilat është dhënë informacioni.

Nënshkrimi i Ankimuesit

_____/_____/_____
Datë

Data e marrjes nga Siguruesi

Formulari i plotësuar se bashku me dokumentat mbështetes do të dërgohet me poste ose dorazi në adresën: INSIG JETE sh.a. Rruga Labinoti Nr 77 Tirane.